REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

# PROCES VERBAL

**Mbledhja jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin 30.12. 2024**

**Data 30.12.2024 ora 11:00.**

**Mbledhja zhvillohet në sallen e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.**

**Me këtë rend dite:**

1.Projekt vendim për shtesë fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transferten e pakushtëzuar të përgjithshme për vitin 2024.
Grupe interesi nuk kishte prezent në mbledhje.Votimet do bëhen të hapura.
Mbledhja jashtë rradhe e Këshillit Bashkiak Vau Dejes e datës 30.12.2024, ora 11.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 18 këshilltarë, (Ferdinad Fusha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca ,Roberto Trushi, Frano Prenga ,Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Aleko Dodani,Mirela Vasija, Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri, Arsen Mehmeti) korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit. Fjalen për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Këshilltarët shprehen dakortësi.
Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 18 vota Pro**.(sipas prezencës)
Z.Ferdinand Fusha largohet nga mbledhja, mbeten prezent 17 këshilltarë.
**Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:**
Projekt vendim për shtesë fondeve për njësitë e vetëqeverisjes vendore në transferten e pakushtëzuar të përgjithshme për vitin 2024.
Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar znj.Elsa Tanushi- drejtore e zyres financë buxhetit, Bashkia Vau Dejës, e cila spjegon se mbështetur në aktin normativ nr.5 date 19.12.2024 per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.97/2023 per buxhetin e vitit 2024 te ndryshuar neni 8,kjo transferte ne rradhe te pare te perdoret per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura dhe pasi te jene shlyer ato te perdoret per shpenzime te tjera.Detyrimet me fondet e Bashkisë janë 2.178.449 lek tëcilat do të shlyhen nga fondi i akorduar nga akti normativ i mësipërm, ndërsa pjesa tjeter e fondit propozojmë që të kalojnë në investimet e infrastruktures rrugore.
Z.Ervis Shimaj pyet këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.
Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.
Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin.**Miratohet me 17 vota Pro, zero kundër,zero abstenim.** Këshilltarët që votuan Pro piken e parë të rendit të ditës: (Ferdinad Fusha, Franga Kola, Kastriot Shkjau, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Majlinda Ndreca ,Roberto Trushi, Frano Prenga, Ervis Shimaj, Rita Preçi,Ornela Lleshi, Aleko Dodani,Mirela Vasija, Mark Bisha, Martin Mardoda, Besmir Kapaj, Ermir Tahiri, Arsen Mehmeti)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari i Këshillit Bashkiak Vau Dejës e deklaron të mbyllur mbledhjen jashtë rradhe e datës 30.12.2024.

**Mbajtësi i Protokollit**

**Sekretari Këshillit**

**Ardian ÇELEPIJA**

Këshilltarët:

Evis Shimaj

Veli Kapllanaj

Franga Gjeto

Frano Prenga

Ornela Lleshi

Majlinda Ndreu

Leonora Prenga

Ermir Tahiri

Rita Preçi

Kastriot Shkjezi

Besmir Kapaj

Mirela Vasija

Roberto Troshli

Aleko Dodani

Ferdinand Fusha

Mark Bishi

Martin Marupaka

Arsen Mehmeti

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006,     e-mail: info@vaudejes.gov.al*